



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assemble

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
Mbledhja nr. 05/2015
Prishtinë, më 19.1.2015, në orën 19:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Fatmir Limaj, anëtarë.

I ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi, OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikës të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Kryetari i komisionit, Muhamet Mustafa, tha se sot Kuvendi ne përputhje me Rregulloren e Punës bëri shmangie dhe ky projektligj sot do të miratohet edhe në leximin e dytë. Pra, Projektligji Nr.05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, është aprovuar në parim në lexim të parë në seancën e sotme plenare dhe tani do ta bëjmë leximin dytë në Komision. Propozim të mundshëm nga deputetët, deri më tani nuk kemi pranuar. Por, theksoi se kemi një propozim nga Qeveria dhe për këtë i kemi përfaqësuesit e Qeverisë, respektivisht ministrin Blerand Stavileci.

Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), paraqiti amendamentin në emër të Qeverisë, me arsyetimin se dispozita tani më këtë ndryshim është me e qartë dhe me këtë tha ai, i ikim të gjitha dilemave duke e shpëtuar “Trepçën” nga likuidimi.

Ministri propozoi amendamentin si në vijim:

Neni 3, të ketë riformulim si vijon:

“Neni 41, paragrafi 1, i Ligjit bazik, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të Ligjit të ndryshuar për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pas kalimit të periudhës prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh nga afati maksimal i lejuar me Nenin 22 dhe, në rast se edhe pas këtij afati:”

Raif Qela kërkoi që në amendamentin e propozuar nga ana e Qeverisë të precizohet fjalia “pas afatit 18 muaj” kur fillon, nëse ka mundësi të zgjatët afati “prej 36 muaj”, sepse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, mund të vendos që ka përfunduar afati prej 18 muaj dhe ketë mund ta interpretojë në këtë mënyrë.

Kryetari tha se këtij propozimi duhet ti shtohet edhe fjalia “në pajtim me nenin 2, të këtij ligji” sepse hiqen dilemat te neni 22, i ligjit në fuqi.

Besnik Berisha, këshilltar i kryeministrit Isa Mustafa, tha se situatës të cilës po i referohemi, është se kemi një vendim nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, që nuk ka më afat të shtyhet. Ndërsa tani më këtë propozim, sipas nenit 2 dhe 3 të projektligjit, kemi bërë të mundshëm një situatë të re juridike dhe të drejtën e shtyrjes së afatit nga ana e AKP-së, dhe Gjykata nuk mund të urdhërojë likuidimin e një ndërmarrjeje pa kaluar edhe 18 muaj.

Kryetari i komisionit, Muhamet Mustafa, për nenin 22 të ligjit bazik që është ndryshuar këtu, pyeti se a është afati maksimal i lejuar në pajtim me nenin 3, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre?

Besnik Berisha, këshilltar i kryeministrit Mustafa, sqaroi se Gjykata nuk mund të bëjë likuidimin pa kaluar afati 18 muaj, i paraparë tani më ndryshimin e nenit 22, të ligjit bazik. Ai theksoi se ndryshimi është bërë vetëm në afat, duke e shtuar kohëzgjatjen e dorëzimit të Planit për Riorganizimin Ndërmarrjes “Trepça”, pavarësisht kësaj, tha ky, kjo nuk nënkupton që mund të kemi mbrojtje në Gjykatë, por me këtë ligj e pamundësojmë Gjykatën të hapë procedura para kësaj periudhe të caktuar.

Kryetari i komisionit, Muhamet Mustafa, propozoi amendamentin e riformuluar si në vijim:

Neni 3, riformulohet si vijon:

Neni 41 paragrafi 1, i Ligjit bazik, fshihet dhe riformulohet si në vijim:

1. Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të Ligjit të ndryshuar për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pas kalimit të periudhës prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh nga afati maksimal i lejuar me Nenin 22, të Ligjit bazik dhe në pajtim me Nenin 2, të këtij Ligji dhe, në rast se edhe pas këtij afati:

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Sala Berisha- Shala tha që ky formulimi i amendamenteve duke u thirrur edhe në ligjin bazik nuk është shumë i kuptueshëm, sepse ne mund të ndërhyjmë vetëm në tekstin e projektligjit të cilin e ka sjellë Qeveria. Propozoj që të shtohet në projektligj fjala “bazik”, aty ku i referohemi ligjit në fuqi.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Amendamente i Projektligjit nr.05/L-08, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-035, për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre;

2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme dhe Kuvendit, sipas procedurës për lexim të dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 19:45

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa